



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA IV

**Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 90.
Prishtinë, më 11.03.2014 në ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302**

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Saša Milosavljević, Jelena Bontić, Mufera Sinik, dhe Mursel Halili.

Munguan: Hatim Baxhaku, Glauk Konjufca, Petar Miletić dhe Rasim Demiri

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuese e OSB-së, Elita Vokshi, përfaqësuesi i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Živković** –kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës së Zyrës së Komisionerit për gjuhët, për vitin 2013.**

I ftuar: Komisioner për gjuhët, Slaviša Mladenović.

Kryesuesja- Hapi takimin duke falënderuar për përgjigjen në ftesën e Komisionit, komisionarin për gjuhët, Slaviša Mladenović. Ajo ceku se Grupi punues i komisionit për të drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe kthim është në procesin e monitorimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve dhe për këtë fjalën ia dha kryesueses së grupit punues.

Jelena Bontić- në kuadër të monitorimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, Komisioni është drejtuar me shkresë, Zyrës së komisionarit për Gjuhët që të sjellin raportin e punës për vitin 2013.

I njëjti është dorëzuar në komision, dhe mund të thuhet se është një raport i punuar mirë. Ajo theksoi se është ftuar komisionari për gjuhët që të prezantojë aktivitetet e punës, të gjeturat për gjendjen e zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve dhe pengesat me të cilat janë ballafaquar.

Slaviša Mladenović- komisionari për gjuhët, shprehu qëndrimin e tij se në raportin vjetor të punës janë përfshirë aktivitetet e zhvilluara në kuadër të mandatit të zyrës dhe në bazë të planit të punës për vitin 2013, i cili është miratuar nga Bordi për politika gjuhësore,

Si detyrë kryesore e zyrës së Komisionerit për gjuhët është procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, me qëllim të ruajtjes, promovimit dhe mbrojtjes së përdorimit të gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës, të institucioneve për zbatimin e legjislacionit i cili rregullon këtë fushë. Me Ligjin për përdorimin e Gjuhëve, garantohet se gjuhët zyrtare përdoren në baza të barabarta në secilën komunë.

Prej emërimit tim si komisionar, janë zhvilluar procedurat e formimit të Zyrës së Komisionerit për gjuhët në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Sipas mandatit dhe përgjegjësisë së zyrës tona janë siguruar mjetet për punë, janë punësuar personeli i parë. Në kuadër të planit të punës për vitin 2013, Zyra ka zhvilluar aktivitete të ndryshme, mbajtja e tryeza të rrumbullakëta, pjesëmarrja në debate të shumta. Janë mbajtur punëtori pune me ministri përkatëse dhe Komisionin Evropian ku janë analizuar problemet

Njëherit janë analizuar problemet e institucioneve me të cilat janë ballafaquar dhe kanë hasur në probleme në zbatimin e Ligjit, dhe kanë dalë me rekomandimet se ka mungesë të mjeteve financiare. Numri i shërbyesve civil të cilët njohin dy gjuhësinë është i kufizuar, shërbimi i përkthyesve është i pamjaftueshëm për të përballuar të gjitha kërkesat për shërbim të dy gjuhësisë dhe mungon sistemi kualifikues i certifikimit të gjuhëtarëve për shërbime të përkthimit dhe interpretimit.

Ekziston si problem edhe mbingarkesa në punë të përkthyesve, nga se përkthejnë shumë faqe në ditë andaj kualiteti i përkthime del i mangët. Dhe si çështje tjetër me rëndësi është se koeficienti i përkthyesve është shumë i ulët 5-7, andaj kjo çështje kërkon zgjidhje konkrete.

Pas aktiviteteve të informimit publik, kemi pranuar dhjetë ankesa të cilat janë shqyrtuar dhe zgjidhur pa pasur nevojë për hetime dhe për ndëshkim sepse institucionet kanë vepruar sipas rekomandimeve tona.

Jelena Bontić- bazuar në të dhënat e raportit, përveç dhjetë ankesave të qytetarëve kërkoi informatë sa ankesa tjera keni marrë dhe nëse po, cilat janë forma e procedimit të tyre.

Slaviša Mladenović – në bazë të të dhënave të vitit të kaluar qytetarët kanë hezituuar të paraqesin ankesa. Gjegjësisht, në muajin shkurt të këtij viti, numri i ankesave është dyfishuar që do të thotë aktivitetet e ZKGJ, ka dhanë rezultate për rritjen e nivelit të informimit për qytetarët.

Jasmina Zivković – duke marrë parasysh si detyrë kryesore e zyrës së komisionarit është monitorimi i zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, mendon se me aprovimin e rekomandimeve efekti do të jetë më i madh, mbi zbatimin e Ligjit në praktikë.

Ajo e kishte të paqartë çështjen e shqyrtimit të ankesave me anë të ndërmjetësimit, nga se shumica e tyre janë zgjedhur pa u bërë hetime zyrtare.

Zyra e komisionarit për gjuhët ka bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, të cilët kanë dalë me rekomandime se mungojnë mjetet financiare për. Lidhur me këtë problematikë kërkoi informatë, pse institucionet nuk kanë dalë me propozim për rritjen e buxhetit, që në të ardhmen të respektohet Ligji. Nga aspekti gjuhësor, një ndër aktivitetet më të rëndësishme të ZKGJ, është auditimi i të gjitha Projektligjeve që vijnë nga Qeveria. Kërkoi të informohet komisioni, se cila është forma me të cilën drejtoheni për korrigjime gjuhësore të Projektligjeve. Më pas shtoi, se mirë është që korrigjime gjuhësore të dërgohen edhe në komisionin tonë pasi janë të rëndësishme korrigjimet e shumë projektligjeve.

Sa i përket monitorimit të terminalit të aeroportit të Prishtinës, keni parashtruar disa herë vërejte, ndërsa ende nuk janë bërë korrigjimet. Cilat janë procedura e mëtejme në rastet e mos përmbushjes së obligimeve gjuhësore ndërsa janë të obliguar të respektojnë rekomandimet e ZKGG.

Slaviša Mladenović – sa i përket ndërmjetësimit për ankesa, mundësitë e zgjedhjes së tyre janë të garantuara me Rregulloren e punës së ZKGG, zyra jonë aktivizon resurset për ti komunikuar qytetarët dhe institucionet, rregullat e përcaktuara me legjislacionin për gjuhët dhe zbatimin e tyre. Në rastet kur paraqiten ankesat e qytetarëve ose të institucioneve përgjegjëse dhe të njëjtat nëse kanë rezultuar në evitimin dhe respektimin e normave gjuhësore, në këto raste përfundon misioni i zyrës tonë. Ndërsa, si obligim mbetet vetëm të vëzhgohet sa respektohen aktvendimet e lëshuara nga ZKGG.

Në planin e punës të vitit 2014, kemi parashikuar që në muajin prill të fillohet me vizita për mbikëqyrjen e institucioneve përgjegjëse dhe të komunave. Do të vendosim indikatorë për zgjedhjen e problemeve dhe pas përmbledhjes së dëshmimeve në teren, do të dalim me rekomandime konkrete.

Bazuar në standardizim të projektligjeve, si pilot projekt në bashkëpunim me ECMI -Qendrën Evropiane për çështje të pakicave, janë diskutuar problemet që kanë të bëjnë me cilësinë e përkthimeve dhe harmonizimeve gjuhësor të projektligjeve. Në bisedime jemi me zyrën juridike pran kryeministrit, dhe kemi propozuar strategjinë për përmirësimin e përgatitjeve të projektligjeve nga ana e ministrive, pra propozimi jonë është që të rritet efikasiteti i përkthimeve dhe i lektorimit.

Sa i përket çështjes së monitorimit të Aeroportit Ndërkombëtar Adem Jashari të Prishtinës, para 10 ditëve keni dërguar një shkresë për përmirësimin e gabimeve gjuhësore të mbishkrimeve në gjuhën shqipe dhe serbe, ndërsa deri në fund të vitit 2013, nuk janë bërë korrigjimet e kërkuara.

Nëse institucionet përkatëse nuk i zbatojnë rekomandimet tona, së pari i konstatojmë arsyen e nëse ka shkelje atëherë do të ndëshkohet personeli përgjegjës.

Jelena Bontić - u ndërlidh me ndëshkimin e personave përgjegjës, pasi dihet se me Ligjin për gjuhët asnjë nen nuk parasheh sanksionimin e personit të autorizuar apo institucionit që bën shkeljen e Ligjit Ishte e interesuar të dijë se cilat janë sanksionet me të cilat duhet të ndëshkohen.

Slaviša Mladenović -. kjo çështje është rregulluar me Udhëzim Administrativ të lëshuar nga Ministria e Pushtetit Lokal, për caktimin e ndëshkimeve për shkeljen e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, këtë autorizim e ka edhe ZKGG. Gjithashtu zyra jonë ka bashkëpunim me institucionet publike me qëllim të zgjedhjes së çështjeve në rastet e shkeljeve para se të aplikohet ndëshkimi. Nëse një institucione përgjegjëse i përmbahet rekomandimeve brenda afatit të caktuar, atëherë Komisioni për gjuhët është i autorizuar që të lëshojë ndëshkime administrative kundër organeve që e shkelin ligjin.

Rasim Demiri –tha se me ligj është e garantuar se secili komunitet ka të drejtën e informimit në programin e RTK-së, ndërsa mungon sinjali në gjuhën boshnjake për qytetarët e Dragashit.

Lidhur me çështjen e ankesave, mendon se nuk është i mjaftueshëm vetëm procesi i monitorimit të aeroportit, unë kamë qenë anëtar në hartimin e këtij raporti, ku kamë ngritë çështjen se të gjitha institucionet shkelin Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, cilat veprime janë marrë për ankesa të tilla.

Mursel Halili – e përgëzon komisionarin për hartimin e raportit në formën më të mirë. Ai tha se raporti përfshirë shumë aktivitete ndërsa si problem është nxjerr mungesa e mjeteve buxhetore. Andaj ishte i interesuar të dijë sa mjete buxhetore janë ndarë për ndjekjen e kurseve në gjuhët zyrtare, për fushatën e mediave në Web faqe institucionale dhe për këto çështje sa e keni mbështetjen e Qeverisë.

Ngriti çështjen e mungesës së sinjalit të transmetimit në gjuhën boshnjake në programin e RTK-së e cila mungon në rajonin e Prizrenit dhe Dragashit dhe kërkesa e tij ishte sa më parë të eliminohet ky problem. Dhe si pyetje plotësuese parashtrroi se në çfarë përbërje është stafi i ZKGG.

Lumnije Morina – në bazë të raportit të ZKGJ nuk po figuron në çfarë shkallë zbatohet Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, në komunat specifike siç janë komuna e Graçanicës, e Shtërpçës, kur dihet se gjuha shqipe, gjuha serbe dhe alfabeti i tyre janë gjuhë zyrtare dhe kanë status të barabartë në Institucionet e Kosovës.

Albert Kinolli- theksoi se ka njohuri për mos kompletimin e stafi të zyrës tuaj sepse njëri nga tetë anëtarët e ZKGJ duhet të jetë nga komuniteti romë. Kërkesa e tij ishte të informohet për plotësimin e këtij vendi të punës pasi është e përcaktuar me Ligji.

Slaviša Mladenović –theksoi se Zyra e komisionarit ka për qëllim promovimin dhe mbrojtjen e gjuhëve zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtar nëpër komuna, për të siguruar mbrojtjen e gjuhëve të komuniteteve e të cilave gjuha amtare nuk janë gjuhë zyrtare.

Ai theksoi se përkatësia etnike e shërbyesve civil nuk mund të përcaktohet me Ligj por shtoi duhet të ekzistojnë kushtet e nëpunësve civil dhe të cilët duhet respektuar. Bordi për politikat gjuhësore bën mbikëqyrjen e aktiviteteve tona ndërsa ne i raportojmë për veprimet tona.

Ku bëhet fjalë për ndjekjen e kurseve profesionale, zyra jonë ka paraparë të nevojshme ofrimin dhe trajnimin e të gjithë nëpunësve civil për të fuqizuar aftësitë gjuhësore në të dy gjuhët zyrtare. Ky projekt është zhvilluar në partneritet me ECMI dhe ka hasur në mirëkuptim nga të gjithë kryetarët e komunave në mbështetje të këtij projekti.

Sa i përket përdorimit të gjuhëve, qasje kanë në stacionet lokale edhe në gjuhën boshnjake. Si shembull morri redaksinë e RTK-së e cila ka ndarë shpërblim për botimin më të mirë në gjuhën boshnjake.

Ai shtoi se ZKGJ, pllakatet i ka shtypur në gjuhët zyrtare në nivel komunal. Gjithashtu, në fund të vitit 2013 kemi incizuar katër spote në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe në gjuhën boshnjake, së shpejti pritet të transmetohen në kanalin e RTK-së.

Me vet iniciativë, zyra ka ndërmarr veprim në kontrollin e faqeve të internetit të komunave. Monitorimi është bërë duke krahasuar përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare në nivel lokal.

Kemi vërejtur se mbishkrimet janë të paraqitura në gjuhët zyrtare, përveç që ka gabime gjuhësore dhe mund të thuhet se një pjesë e tyre nuk i përmbushin përgjegjësitë në pajtueshmëri me Ligjin.

Zyra e Komisionarit për Gjuhët ka mandat ligjor që të hetojë dhe ti zgjedh ankesat në rastet e shkeljeve të të drejtave gjuhësore, të ngrit vetëdijesimin publik për legjislacionin për gjuhët.

ZKGJ i heton të gjitha ankesat, i zhvillon aktivitetet që të kryhen hetimet. Deri sot të gjitha shkeljet e gjuhësore janë evituar dhe zgjedhur pozitivisht.

Muferra Sinik –.Në raportin e ZKGJ për vitin 2013, shihet se ka mungesë të mjeteve buxhetore, kjo çështje e vështirëson mundësin e zbatimit të Ligjit për gjuhët. Sa i përket çështjes së buxhetit, ZKGJ ka planifikuar të botojë një doracak, pyetja e saj ishte është përfunduar dhe nëse po atëherë a është botuar në gjuhët zyrtare dhe në gjuhëve në përdorim zyrtar në komuna.

Shihet se zyra juaj ka bërë përpjekje për informim të qytetarëve por këtë e keni bërë vetëm në gjuhë shqipe, që kjo paraqet pakënaqësi për komunitetet jo shumicë.

Pyetja e radhës ishte se cila strukturë është e punësuar në ZKGJ bazuar sipas përkatësisë së komuniteteve pasi kjo çështje është e përcaktuar me Ligj.

Nga ana juaj dëgjuam një informatë të mirë se keni inqizua katër spote në të gjitha gjuhët.

Slaviša Mladenović- në batë të Ligjit, kuota për punësimin e komuniteteve është parashikuar 10%, numri i të punësuarve është 8, që i bie që zyra jonë i ka përmbushur standardet e punësimit me përfaqësues të të gjitha komuniteteve.

Sa i përket pyetjes të broshurave dhe pllakateve, siq e kamë cekur edhe më lartë, ato janë shtypur në të gjitha gjuhët zyrtare.

Jelena Bontic- falënderoi komisionarin për informatat e dhëna të cilat mendon se janë të dobishme për të gjithë anëtarët e Komisionit.

Në kuadër të diskutimeve, shihet se nuk respektohet një pjesë e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në terren, gjë që e vështirëson qasjen konkrete si për institucione ashtu edhe për qytetarët.

Grupi punues do të vazhdojmë me monitorimin e Ligjit, do të vizitojmë disa komuna dhe institucione dhe më pas do të dalim me rekomandime konkrete për Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković